



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më .03.2026

MBLEDHJA Nr. 13,
Datë 12 .03.2026, ora 12:00
e Bordit të ERE-s.

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte , datë.12.03.2026, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr.13, e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi kërkesën e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM”sh.p.k për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 50 MW.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY”sh.p.k për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 30 MW.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY”sh.p.k për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 10 MW.
4. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 302, datë 17.11.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “SPITALLA SOLAR”sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.
5. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “NOA ENERGY TRADE”sh.p.k, për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës.

6. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.p.k, për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për HEC Moglicë dhe HEC Banjë.
7. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k, për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltai.
8. Mbi miratimin i disa ndryshimeve në ‘Rregulloren për Cilësinë e Furnizimit dhe Performacën e Sigurisë së Rrjetit në Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike’, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.207, Datë 18.12.2017 dhe Treguesit e Kriteve Standarde të Cilësisë së Shërbimit në Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI